

## I. HYRJE.

Subjekti IMPULS INDUSTRI sh.a është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti L226072030.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: ELBASAN, Bradashesh, Ish Kombinati Metalurgjik, pranë Uzinës nr.12.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: “Grumbullim, transport, riciklim e shpërbërje të mbetjeve të gomuaara nëpërmjet pirolizës. Shitje me shumicë e pakicë si dhe eksport i produkteve të përfituara nga shpërbërja e gomave, si vaj i rafinuar dhe lëndë djegëse të lëngshme e të ngurta. Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të gomave dhe gomave jashtë përdorimit”.

Administratori i këtij subjekti është z. Arjan Shyti.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit B:

**Veprimtaritë e gomës, ID 7.11/b. Përveç rasteve të përmendura në ndonjë nga veprimtaritë e tipit A, në këtë shtojcë, trazimi, bluarja, ose përzierja e: i. Gomës natyrale; ose ii. Elastomerëve me përbërje sintetike organike, n.q.s është përdorur karbon i zi.**

**Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, ID 7.12/s Shndërrimi i gomës.**

**Menaxhimi i mbetjeve, ID 5.4/c Rikuperimi i mbetjeve jo të rrezikshme.**

**Prodhimi i produkteve plastike, ID 7.13 Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundëshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

## II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.


- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhri e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

## III.INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

**Profili i subjektit “IMPULS INDUSTRI” për “Trazimi, bluarja, ose përzierja e: i. Gomës natyrale; ose ii. elastomerëve me përbërje sintetike organike, n.q.s është përdorur karbon i zi. Shndërrimi i gomës”.**

Instalimi për “Trazimi, bluarja, ose përzierja e: i. Gomës natyrale; ose ii. elastomerëve me përbërje sintetike organike, n.q.s është përdorur karbon i zi. Shndërrimi i gomës” të subjektit “IMPULS INDUSTRI” është i pozicionuar në Elbasan Bradashesh BRADASHESH Ish Kombinati Metalurgjik, zk.3965, pasuria nr.432/3, pranë Uzinës nr.12. Kjo shoqëri është

regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për aktivitetin në fushën e Grumbullim, transport, riciklim e shpërbërje të mbetjeve të gomuara nëpërmjet pirolizës. Shitje me shumicë e pakicë si dhe eksport i produkteve të përfituara nga shpërbërja e gomave, si vaj i rafinuar dhe lëndë djegëse të lëngshme e të ngurta. Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të gomave dhe gomave jashtë përdorimit me NR NIPT: **L226072030**.



	X	Y
1	4418720.19	4551073.05
2	4418740.51	4551026.19
3	4418785.84	4551047.23
4	4418762.98	4551092.86

## ID 7.12/s Përshkrimi i procesit teknologjik

Subjekti në fjalë nëpërmjet procesit të pirolizës të gomës, i cili është hermetikisht i mbyllur prodhon 3 komponentë kryesorë: **Fuel oil-i** i cili është vaj i djegshëm i përftuar nga piroliza e gomës; **Antracite (karbon i zi)** i cili është artikull që shitet nëpërmjet proceseve doganore dhe **Materiale ferore**. Këto produkte lejohen të tregtohen për eksport dhe brenda vendit sipas kërkesave.

“IMPULS INDUSTRI” sh.a nuk realizon më pirolizë të vajrave lubrifikantë (vajra të përdorur) por realizon vetëm pirolizë gome duke prodhuar 3 produkte bazë: Antracite, Fuel Oil dhe produkte hekuri.

### **PROCESI I SAKTË TEKNOLOGJIK**

Për të patur një vlerësim të drejtë të problemeve mjedisore që dalin gjatë funksionimit të linjës së shpërbërjes së gomave të përdorura për prodhimin e vajit të djegshëm (solar) dhe nënprodukteve të ngurta si karboni i zi dhe skrapit është e nevojshme të njihemi me teknologjinë e prodhimit të detajuar në çdo hallkë. Ndërtimet dhe montimet e bëra janë në përputhje me teknologjinë e ushtrimit të aktivitetit. Ndërkohë janë realizuar të gjitha sistemet ndihmëse që kanë të bëjnë me funksionimin e rrjetit ujqor përgjatë gjithë zonës ku ushtrohet aktiviteti. Furnizimi me ujë bëhet nga një pus me kapacitet 100 l/minutë. Cilësia e ujit është e pranueshme. Gjithashtu është në funksionim dhe sistemi i lavazhit me anën e pompës së ujit me presion dhe që siguron pastërtinë e ambjenteve.

Është instaluar ujë i ngrohtë me ngrohje nga panelet diellore, lavamanë me rubineta me mishelatorë të komandueshme me dorë dhe ndriçim adekuat. Janë instaluar dhe neone për eliminimin e insekteve. Furnizimi i punonjësve me rroba dhe vegla pune bëhet sistematikisht. Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi bëhet rregullisht në mbështetje të një plani të hartuar. Është realizuar ngritja e sistemit të shkarkimit konform kërkesave teknologjike duke i pajisur piletat me rrjeta të imëta që bënë të mundur kapjen e lëndës së trashë. Është vendosur gjithashtu një impiant zjarr fikës që mbulon të gjithë territorin e aktivitetit.

Sikundër kemi përmendur dhe mësipër, subjekti realizon përpunimin e mbetjeve urbane që në rastin konkret përfaqësohen nga gomat e makinës dhe elastomerët dhe që më poshtë do të bëhet përshkrimi i hollësishëm i teknologjisë së përpunimit të tyre. Gomat e përdorura të makinave dhe të dala jashtë përdorimi grumbullohen dhe sistemohen në sheshin e përcaktuar për to. Ato sistemohen sipas tipeve dhe dimensioneve duke i bërë dhe një pastrim paraprak nga papastërtitë që mund të shoqërojnë ato me natyrë inorganike.

Fillimisht linja përgatitet për punë:

- Paraprakisht bëhet prerja e gomave në pjesë të vogla, të dala jashtë përdorimit në makinën prerëse.
- Bëhet mbushja e reaktoreve 1 dhe 2 me gomat e dala jashtë përdorimit.
- Sigurohet:
  - furnizimi i të gjithë linjës me energji elektrike.
  - mbyllja e linjës së gazit të ardhur nga procesi dhe saracineskave të tjera përveç saracineskës të kolonave në dalje të reaktorit 1-1 dhe 2-1 (për largimin e avujve të ujit).
  - uji në hidrombyllësa të jetë në nivelin e përcaktuar.
- Së pari ndizen pompat e ujit të sistemit ftohës i cili punon pa ndërprerje gjatë gjithë procesit. Uji qarkullon përmes ftohësit të ujit qarkullues 14.

Vihen në punë aspiratorët 1-10 dhe 2-10.

- Ndizet pompa e ujit ftohës e qarkullues të gazrave të lëndës që ngrohin reaktorin (gazrat kalojnë në filtrin 1-2 dhe 2-2).
- Pas këtvre manovrimeve bëhet ndezja e sprucatorëve të vajit një e nga një.

- Fillon rritja graduale e temperaturës.
  - Në temperaturën  $T=100^{\circ}\text{C}$  te kolona 1-1 dhe 2-1 në dalje të reaktorit, mbyllet saracineska e shkarkimit në atmosferë të avujve të ujit.
  - Nga ky moment duhet të monitorohen me kujdes parametrat teknologjikë (P, T)
    - a) Temperatura maksimale në kolonën dalëse të furrës:  $T=340-360^{\circ}\text{C}$
    - b) Presioni maksimal në kolonën në dalje të reaktorit:  $P=0.007\text{Mpa}$ .
    - c) Temperatura maksimale në reaktor:  $T = 400-450^{\circ}\text{C}$
  - Prodhimi i gazit tregon që kanë filluar reaksionet e shpërbërjes pirolitike në reaktorin 1 dhe 2.
  - Në varësi të procesit dhe rritjes së presionit në kolonën dalëse të reaktorit, sprucatorët e vajit fiken një e nga një deri në  $T=200^{\circ}\text{C}$ .
  - Në këtë moment i gjithë sistemi është i mbyllur dhe punohet vetëm me gaz të prodhuar.
  - Gazi i prodhuar, fillimisht kalon në kolonën 1 -1 dhe 2-1.
  - Më pas gazi kalon në ftohësat 1-3, 1-4, 1-5, 2-3, 2-4, 2-5, kupjesa e rëndë kondensohet dhe mbetet në ftohësa.
  - Gazrat më të lehtë kalojnë nga ftohësat 1-4, 1-5, 2-4, 2-5 dhe kondensojnë në ftohësin horizontal 1-6, 2-6. Ky është vaj i pastër i cili kalon në depozitën 5. Me pas gazi pasi kalon në ftohësat 1-7, 2-7 kondensohet në pishinën ftohëse me serpentinë 13.
  - Vaji i kondensuar mblidhet në depozitën 1-9, 2-9.
  - Vaji i rëndë i kondensuar në ftohësat 1-3, 1-4, 1-5, 2-3, 2-4, 2-5, kalon në mbledhësin 3 dhe më pas në depozitën 4.
  - Teprica e gazit riqarkullon duke kaluar në hidrombyllësat 1 -8, 2-8 dhe përdoret për ngrohjen e reaktorit 1 dhe 2.
- Proçesi është drejt përfundimit atëherë kur fillon ulja graduale e temperaturës në kolonën në dalje të reaktorit 1-1 dhe 2-1.
- Fikja e sprucatorëve të gazit vjen si rezultat i përfundimit të procesit.
  - Gjatë kësaj kohe sistemi i aspirimit 1-10, 2-10 dhe sistemi ftohës i tij lihen të punojnë.
  - Vaji i rëndë i depozitës 4 dhe vaji i pastër i depozitës 5, me anë të pompave kalojnë në proces mishelimi në filtrin e vajit 6.
  - Produkti i mbledhur në depozitat 1-9 dhe 2-9 kalon përsëri me anë të pompave në proces mishelimi në filtrin e vajit 6. Vaji djegës (Solar) nga procesi i mishelimit në mishelatorin Nr.6 kalon në filtrin mekanik Nr.18 dhe nëpërmjet pompës (me kontaktër) Nr.19 depozitohet si produkt i gatshëm për shitje në tankerat Nr.15 dhe Nr.16.
  - Nxehtësia për procesin e mishelimit prodhohet nga energjia elektrike.
  - Reaktorët konsiderohen të ftohur vetëm atëherë kur temperatura në reaktor arrin vlerën  $75^{\circ}\text{C}$ . Në këtë moment mbyllet saracineska e shkarkimit në atmosfere të kolonës 1-1 dhe 2-1.
  - Karboni i zi pluhur me pas thithet nga magnet thithësi 8 dhe 9 (ketu mbesin dhe ashkla metali). Me pas karboni i zi kalon në grup vakumi 10 dhe pastaj depozitohet në tankerin 11.
  - I gjithë karboni i zi sistemohet në thase Big bag dhe sistemohet për shitje.
  - Në fund reaktorit 1 dhe 2 ndalohen dhe hapet bankoporta e madhe.
- Produkti që mbetet brenda në reaktor janë skrapet, i cili nxirret dhe depozitohet dhe shitet sipas kontratave (KURUM INTERNATIONAL).

Një cikël pune zgjat 22-24 orë.

## **ID 5.4/c Përshkrimi i procesit teknologjik**

Mbetjet jo të rrezikshme pasi grumbullohen me mjetet teknologjike, i nënshtrohen procesit të seleksionimit sipas rrymave prioritare të mbetjeve.

- ***Grumbullim, presim, granulim i plastikës***

Ky proces fillon me grumbullimin e plastikës nga operatorë të licensuar. Materialet shkarkohen në ambientet e përcaktuara brenda territorit të objektit, ku është vendosur dhe peshorja për peshimin e materialit të ardhur (plastikës). Ambientet janë organizuar në funksion të veprimtarisë që nga ardhja dhe shkarkimi i lëndës së pare (mbetje plastike) dhe seleksionimi (ndarja sipas ngjyrës), peshimi, pastrimi nga papastërtitë, seleksionimi dhe grirja (granulimi).

Disa nga makineritë dhe pajisjet janë:

- Tranxhë
- Grirësi
- Transportier
- Piru etj.

### ***Përpunimi i plastikës.***


Mbetje plastike: Kodi  
1601 19 Plastika  
1702 03 Plastikë

Proçesi i përpunimit do nisë me seleksionimin dhe sistemimin e plastikës që vjen në subjekt. Në forma të vogla të grupuara, plastika do “ngarkohet” në konvejerin me pllaka që do të jetë edhe pajisja e parë në linjën teknologjike. Ky elevator do dërgojë ngarkesën në coptuesin me fletë i cili do bëjë thyrjen apo grimcimin në copra relativisht të mëdha të ngarkesës. Me ndihmën e elevatorit, ngarkesa e coptuar do shkojë në pajisjen e parë larëse ku nën presionin e ujit prej saj do largohen papastërtitë shoqëruese kryesisht të ngjitura në mënyrë mekanike. Prej këtej, përsëri me ndihmën e një shneku, ngarkesa do shkojë në një coptues tjetër me fletë në të cilin do të bëhet një thyerje në përmasa më të vogla të coprave të plastikës. Ky material i grimcuar më tej do kalojë në pajisjen tharëse, në të cilën realizohet largimi i lagështisë sipërfaqësore apo të grimcave të ujit që i është bashkangjitur coprave të plastikës. Pas këtij procesi, ngarkesa do shkojë në pasijen e cila bën nxehtjen apo ngrohjen e saj deri në temperaturën 70-80 °C, temperaturë kjo e nevojshme për zbutjen e saj. Pasi merr nxehtësinë e nevojshme ngarkesa do shkojë në pajisjen granuluese në të cilën do formohen peletat me madhësinë e kërkuar.

Pas këtij procesi, ngarkesa e granular do shkojë në bunkerin e produktit të gatshëm, ku ajo do mund të ngarkohet në thasë ambalazhi apo në kamjonë rifurxhio të cilët e transportojnë atë për riciklim.

Duke përjashtuar procesin e seleksionimit të mbetjeve plastike (lëndës së parë), zhvillimi proceseve të tjera, do të jetë tërësisht i mekanizuar, ç’ka do të thotë se gjatë zhvillimit të tij punëtorët do të jenë thjeshtë vëzhgues të ecurisë së punës dhe ndërhyrja e tyre në proces do të bëhet vetëm në raste të avarive apo difekteve të ndryshme teknologjike apo mekanikë.

Pra, do kemi një shkallë rikuperimi të lëndës në masën rreth 80 %.



### ID 7.13 Përshkrimi i procesit teknologjik

Procesi i prodhimit të vajit nga granulat plastike është një proces i njohur si **pirolizë**, i cili përdor nxehtësi për të shndërruar materialet plastike të hedhura (si granulat e plastikës) në produkte të ndryshme, përfshirë vajra dhe karburant. Ky është një proces i rëndësishëm për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e energjisë. Ja një përshkrim i thjeshtë i procesit:

1. **Përgatitja e plastikës:** Granulat plastike grumbullohen dhe pastrohen nga ndotësit si plehra, ngjitës ose substanca të tjera që mund të ndodhin gjatë përdorimit të mëparshëm të plastikës. Ato gjithashtu mund të copëtohen në madhësi të vogla për të përshpejtuar procesin e pirolizës.
2. **Piroliza:** Plastikë e grumbulluar vendoset në një reaktor të pirolizës, një enë që mund të arrijë temperatura shumë të larta, zakonisht mbi 400-500°C, në kushte pa oksigjen (anaerobik). Nën këto kushte, plastika shkohet dhe ndahet në molekula më të thjeshta, duke krijuar gazra, vajra dhe mbetje të ngurta (karbon).
3. **Kondensimi:** Gazrat që dalin nga reaktori kalojnë në një sistem kondensimi, ku ftohen dhe kthehen në lëngje. Këto lëngje janë vajra që mund të përdoren si lëndë djegëse ose në industri të tjera.
4. **Përpunimi i vajrave:** Vajrat e prodhuara gjatë pirolizës janë të pasura me hidrokarbure dhe mund të përdoren direkt si lëndë djegëse për motorë ose mund të rafinohen për të krijuar produkte të tjera si benzinë, dizel ose vajra industriale.
5. **Përfitimet e procesit:** Ky proces ndihmon në reduktimin e mbetjeve plastike që do të ishin të dëmshme për mjedisin dhe gjithashtu prodhon energji të rinovueshme në formë vajrash të lëngshme që mund të përdoren për qëllime të ndryshme.

Në përgjithësi, prodhimi i vajit nga granulat plastike përbën një mënyrë të rëndësishme për të menaxhuar mbetjet plastike dhe për të krijuar një burim të ri energjie nga materialet e riciklueshme. Subjekti "IMPULS INDUSTRI" sh.a të gjithë këtë sasi vaji që do të prodhojë do ta eksportojë, do të përdoret si lëndë djegëse për kaldajat e spitaleve.

IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

#### 4.1. Lëndët e para.

Aktiviteti në fjalë është një aktivitet grumbullimi dhe rikuperimi si dhe prodhimi i vajit nga granulat e plastikës, i cili kërkon përdorim të lëndëve të para dhe atyre ndihmëse si më poshtë:

Lëndë të para	Lëndë/materiale ndihmëse
Poiliutileni	Ujë
Mbetje jo të rrezikshme	Energji elektrike

Lënda e parë që përdoret në linjën e prodhimit janë: gomat e përdorura të automjeteve dhe elastomerët. Lëndët ndihmëse janë: uji industrial (i cili zbutet me kripë deti), pishina ftohëse, uji i bardhë, lëndë djegëse dhe lëndë djegëse e gaztë që përftohet gjatë prodhimit, lëndë djegëse e lëngët (gazoil) dhe energji elektrike.

#### 4.2. Energjitë që përdoren.

Objekti ku zhvillohet kjo veprimtari është i lidhur me rrjetin inxhinjerik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjerik janë, ai i:

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm.

##### a. Furnizimi me energji elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatës me OSSHE e kësaj zone. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike është e domosdoshme për të gjitha proceset teknologjike si dhe përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjeteve të punës, rrugëve etj.

##### b. Furnizimi me ujë.

Furnizimi me ujë bëhet nga Rrjeti Ujësjellës Kanalizime i zonës. Uji do të përdoret në procesin teknologjik si dhe për shërbimet higjieno-sanitare.

## V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

### 5.1. Shkarkime në ajër.

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit në zonë. Të vetmet shkarkime në ajër do të jenë gaze apo grimca pluhuri, të cilat gjenerohen nga lëvizja e mjeteve që përdoren në funksion të aktivitetit, të cilat në pikëpamjen mjedisore dhe shëndetësore këto ndikime mund të konsiderohen të papërfillshme. Nuk gjenerohen shkarkime të konsiderueshme në ajër, por bëhet monitorimi i vazhdueshëm i zonës përreth aktivitetit për kontrollin e cilësisë së ajrit.

### 5.2. Shkarkime në tokë.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit do të gjenerohen këto tipologji mbetjesh:



## **1. Mbetjet urbane (Letra, qese, Karton etj) përfshirë fraksionet e mblledhura veçmas.**

**KOD 20 01 01** Letër dhe karton

**KOD 20 01 02** Qelq

**KOD 20 01 39** Plastikë

Mbetjet urbane të krijuara nga stafi, nuk përbëjnë rrezik për ndotjen e tokës apo të mjedisit ku do të hidhen dhe për këtë arsye konsiderohen mbetje të parrezikshme. Për sa i përket mënyrës së trajtimit/asgjësimit dhe menaxhimit të tyre ato do të depozitohen në kontenier të posaçëm të vendosura nga subjekti. Për menaxhimin e tyre, subjekti ka vendosur kosha me ngjyra në ambientet e instalimit, me qëllim diferencimin e tyre që në burim. Kontenierët do të jenë gjithashtu edhe të mbyllur, për të evituar përhapjen e aromave të pakëndshme sidomos në kohë me temperature të lartë dhe në kontakt me lagështirën.

Në fund të çdo pune, mbetjet e ngurta urbane subjekti do t'i depozitojë në vendin e përcaktuar për to nga Njësia Vendore.

## **2. Mbetjet e krijuara nga aktiviteti**

Proçesi i grumbullimit, seleksionimit, përpunimit dhe grirjes së materialeve të plastikës për riciklim në subjekt është i ndërtuar në formë të tillë që çdo mbetje plastike e krijuar (HDPE, PVC, PE) rifuten në proçesin e prodhimit si lëndë e parë. Kjo për arsye të rritjes së eficensës së punës por edhe për mbrojtjen e mjedisit.

Nga aktiviteti i shndërrimit të gomës gjenerohet një sasi mbetjesh, ku shumica riciklohet. Menaxhimi i mbetjeve brenda zonës së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Elbasan.

Mbetjet e ambalazhura (lëndë e parë) për industrinë e riciklimit transportohen me mjetet e shoqërisë drejt impianteve të riciklimit të mëtejshëm të tyre me qëllim ripërdorimin sa me eficient të tyre, duke ulur kostot e prodhimit për shumë produkte. Proçesi i shndërrimit të gomës është një proçes i mbyllur i cili njëkohësisht redukton mbetjet urbane nëpërmjet grumbullimit dhe që nuk emetojnë pluhura dhe me kontakte minimale me elementët e mjedisit.

Mbetjet i nënshtrohen proçesit të seleksionimit manual nga punonjësit e subjektit. (Mbetjet e papërdorshme depozitohen në kontenierë të posaçëm).

Më pas Mbetjet e gomës nëpërmjet mjetit të transportit të tipit PIRU transportohen në makinerinë e grirjes së gomës, për ti ripërdorur në proçes.

Në kushtin 8 të lejes mjedisore për të cilin subjekti aplikon për ndryshim kushtesh të përmendur më lart janë vendosur mbetje të rrezikshme të cilat subjekti nuk i gjeneron dhe për më tepër e ripërsërisim që gomat sipas katalogut të mbetjeve nuk konsiderohen mbetje të rrezikshme. Subjekti "IMPULS INDUSTRI" sh.a nuk gjeneron mbetjet me kodin:

19 01 07\*-mbetjet e ngurta nga trajtimi i gazeve

19 01 11\*-hira fundore dhe llumra që përmbajnë substanca të rrezikshme pasi llumrat e gomës që gjenerohen janë mbetje të parrezikshme dhe ripërpunohen në proçesin pasardhës së bashku me mbetjet e tjera të gomuara duke mos i konsideruar si mbetje por si lëndë e parë në proçesin e prodhimit.

19 01 13\*-hi fluturues që përmban substanca të rrezikshme pasi e ritheksojmë se subjekti nuk e ka fare si produkt.

19 01 15\*-pluhur kaldajash që përmbajnë substanca të rrezikshme pasi subjekti nuk disponon kaldajë për ngrohje por përdor vetëm energji elektrike për procesin teknologjik.

19 01 17\*-mbetje të pirolizës që përmbajnë substancë të rrezikshme pasi nga piroliza e gomës nuk gjenerohen mbetje të rrezikshme.

19 01 12-hira fundore dhe llumra, të tjera nga ato të përmendura në 19 01 11 pasi llumrat e gomës që gjenerohen ripërpunohen në procesin pasardhës së bashku me mbetjet e tjera të gomuara duke mos i konsideruar si mbetje por si lëndë e parë në procesin e prodhimit.

19 01 14-hi fluturues tjetër nga ato të përmendura në 19 01 13 pasi e ritheksojmë se subjekti nuk e ka si produkt.

19 01 16- pluhur kaldajash të tjera nga ato të përmendura në 19 01 15 pasi subjekti nuk disponon kaldajë për ngrohje por përdor vetëm energji elektrike për procesin teknologjik.

19 01 18–mbetje të pirolizës të tjera nga ato të përmendura në 19 01 17 pasi nga piroliza e gomës nuk gjenerohen mbetje të këtij lloji.

19 01 19-rërat nga shtresat vluese pasi nuk e gjeneron nga procesi i prodhimit.

Kodet e mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti janë 19 01 02-materiale ferore të dala nga hiret fundore për të cilat subjekti ka lidhur kontratë me KURUM INTERNATIONAL sh.a, mbetje urbane, leter dhe karton.

### 5.3.Shkarkime të ujrave të ndotur.

Gjatë procesit kemi përdorimi të ujit për ftohje të produkteve përfundimtare. Ujrat higjieno-sanitare të gjeneruara nga ky aktivitet do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve. Produktet larëse që do të përdoren nga punonjësit e mirëmbajtjes për larjen e ambienteve të brendshme do të blihen sa më miqësore me mjedisin për të reduktuar sado pak ndikimet në mjediset ujore.

### 5.4.Shkarkime të zhurmeve.

Zhurma në nivele minimale do të gjenerohen nga mjetet e transportit, të cilat përdoren nga kompania. Gjithashtu dhe nga makineritë për përdoren për proceset teknologjike në këtë subjekt. Këto zhurma do të jenë brenda normave të lejuara, duke mos shkaktuar shqetësim për banorët e zonës.

## VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Subjekti IMPULS INDUSTRI sh.a me NIPT L22607203O, ushtron veprimtarinë e tij në qytetin e Elbasanit.

**Elbasani është** qytet në Shqipëri dhe njëkohësisht qendër e qarkut dhe rrethit me të njëjtin emër. Elbasani është qyteti i tretë më i madh në Shqipëri. Qyteti i Elbasanit ndodhet në Shqipërinë e Mesme.

### • **Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit**

Elbasani shtrihet në fushën e Elbasanit, në krahun e djathtë të rrjedhjes së mesme të lumit Shkumbin, i rrethuar në lindje nga Krasta e Madhe dhe e Vogël, në veri dhe veriperëndim nga kodrat e Ullishtave, në perëndim nga përroi i Zaranikës, në jug kufizohet nga lumi Shkumbin. Në anën perëndimore të qytetit kalon përroi i Zaranikës dhe nga lindja ai i Manazderies. Elbasani

është i vendosur midis gjerësive gjeografike veriore 41° 27', jugore 40° 10', lindore 20° 34' dhe perëndimore 19° 03' dhe ndodhet në një lartësi mesatare prej 125 m mbi nivelin e detit. Veçoritë klimaterike të kësaj zone janë: dimër i butë e me reshje dhe verë e nxehtë dhe e thatë.

Elbasani është një nga qytetet më të mëdha të vendit me një popullsi prej rreth 128.000 banorësh

- **Pershkrim i faktoreve klimatike**

Veçoritë klimaterike të kësaj zone janë: dimër i butë e me reshje dhe verë e nxehtë dhe e thatë.

Era fryn kryesisht nga drejtimi i veriut. Duke qene se zona karakterizohet nga nje ndryshim i madh kuote per shkak te ndryshimit te temperatures se ajrit ne vere rryma e ajrit leviz nga zonat e uleta ne zonat malore dhe ne dimer ne te kunderten.

Temperatura ne periudhen e dimrit me ngrica te medha (Janar - Shkurt) arrin ne - 2° C, ndersa ne stinen e veres (Korrik – Gusht) temperatura luhetet 27- 41 °C. Ne kete territor bien reshje mesatare te shiut deri 1300mm, kryesisht ne fundin e Vjeshtes dhe ne Pranvere.

Reshjet e Veres bien ne forme rrebeshi. Numri i diteve me reshje lekundet nga 95 - 100 dite.

Ne stinet pranverore dhe te vjeshtes zona pershkohet nga erëra te ngrohta, hera- heres murlani te cilat kryesisht vijne nga prendimi, por edhe nga VL qe sjellin prishjen e motit dhe shkarkim reshjesh. Ne Vere keto erera jane te nxehta dhe te thata qe shkaktojne temperatura te larta deri ne zagushi. Ne periudhen e Dimri erërat vijne nga veriu, qe jane erera te ftohta shoqeruar me ulje temperature e rreshje te dendura debore.

- **Pershkrim i sizmitetit i zones se projektit**

Studimet sizmoteknike kane te bejne me te dhenat per termetet, ato lidhin sizmitetin me shkeputjet aktive. Kushtet e vendosjes strukturore dhe tektonike te ndodhjes se termeteve jane perftuar kryesisht nga analiza pergjithesuese e te dhenave nga gjeologjia, gjeofizika dhe dukurite sizmologjike. Dihet se aktiviteti i sotem termetor lidhet ngusht me strukturen e sotme gjeologjike, me strukturen neotektonike te vendit tone. Eshte tashme e mirenjohur dhe e pranuar nga shumica e studiusve se shkeputjet tektonike jane burimet e clirimit te energjise sizmike. Termeti ndodh atje dhe atehere ku edhe sforcimet e lindura deformimet tektonike, tejkalojne kufirin e fortesise se lendes pergjate ketyre shkeputjeve.

- **Te dhena te pergjitheshme mbi gjeologjine e rajonit**

Spektori i levruar ben pjese ne zonen strukturore faciale apo tektonike jonike. Ne aspektin paleo-gjeografik, depozitimet mbizoteruese jane totalisht te faces karbonatike te tipit te lagunave detare te nje mjedisi subolital dhe interolital ne buzen e brendeshme te platformes karbonatike. Ne aspektin tektonik formon krahun e struktures antiklinale dhe shtrihen me pajtim mbi depozitimet e Kretakut te siperm dhe (Pg12).

Ne gjeologjine e rajonit kemi keto formacione:

1. Formacioni karbonatik i kretakut te siperm
2. Formacioni karbonatik i eocenit te poshtem e te mesem
3. Formacioni mergelor i eocenit
4. Eoceni i siperm
5. Oligoceni
6. Mioceni i poshtem
7. Mioceni i siperm
8. Depozitimet kuaternare

- **Gjeografia dhe- gjeomorfologjia e rajonit**

Qarku i Elbasanit kufizohet: në veri me Qarkun e Dibrës

në veriperëndim me Qarkun e Tiranës në perëndim me Qarkun e Fierit

në jug me Qarkun e Beratit  
në juglindje me Qarkun e Korçës  
në lindje me Republikën e Maqedonisë

### **Shtrirja gjeografike**

Shtrihet në fushën me te njejtin emer, në krahun e djathte të rrjedhes së mesme të lumit Shkumbin ne lartesine 120 m. Është rreth fushor dhe pjeserisht kodrinor-malor. Lartesia mesatare është 440 m. maja më e larte është mali i Jeronishtit (1883 m). Malet ndodhen në verilindje, lindje dhe juglindje (si Labinot dhe Shpati). Kodrat ndodhen në veriperendim, perendim dhe jugperendim si kodrat e Dumresë, Sulovës dhe Llixhës. Fushat ndodhen në pjesën qendrorë si fusha e Elbasanit, Cerrikut, Gostimës.

- **Gjeografia**

Elbasani ka klime te pershtateshme per kultivimin e te gjitha kulturave, qe nga agrumet e perimet ne ambiente te mbrojtura dhe deri tek arrat e geshtenjat si kultura me nevoja ekstreme. Mesatarisht bien 1170 mm reshje ne vit dhe ka nje temperature mesatare vjetore 15 - 18 ° Celcius, me temperature minimale 0 - 3 grade dhe maksimale 32 - 35 grade. Ka mesatarisht 2530 ore ndriçim diellor ne vit dhe 332 dite me diell. Ka nje lartesi mbi nivelin e detit 70 - 128 metra nga Elbasani deri ne Dumre dhe me e larta 1411 metra maja e malit Bukanik. Mbizoteron klima medhetare kontinentale e cila krijon mundesi per plotesimin e nevojave per te gjitha kulturat. Elbasani ka rezervat me te medha ujore ne vend. Ai pershkohet nga dy lumenj, Shkumbini e Devolli, qe veç perdorimit te tyre per ujitje kane sasi te medha inertesh. Rrethi Elbasanit ka 59 ujembledhes me nje siperfaqe prej 800 hektare. Ne 700 hektare te tyre kultivohet peshku. Nga keto, 39 jane natyrore, kryesisht ne Dumre, duke I dhene kesaj zone nje bukuri te rralle dhe mundesi te medha zhvillimi. Ne Komunën Klos kemi 12 hektare siperfaqe ujore ne te cilen kultivohet rasati i peshkut. Thellesia e liqeneve natyrore eshte 7 - 10 m me nje thellesi maksimale 61 m. Temperatura e ujit ne thellesi 25 - 50 cm eshte ne dimer 7.5 ° dhe ne vere 25 ° Celcius, temperature kjo e pershtateshme per gjallesat nenujore gjate gjithe vitit. Keto liqene me rezerva ujore prej 30 milion metra kub, shtrihen ne nje pllaje prej 280 km katror.

- **Popullsia**

Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60% të popullsisë së bashkisë ndërsa pjesa tjetër është e ndarë në shumë njësi administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore.

Bashkia e re ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë fabrikën e çelikut, atë të çimentos, ferrokromit, etj, gjë që i ka dhënë kësaj zone edhe një nga nivelet më të larta të ndotjes së ajrit në vend.

Elbasani është një nga zonat më të varfra në Shqipëri për shkak se qyteti u ndërtua gjatë kohës së komunizmit për të përqendruar disa dhjetëramijëra punëtorë përreth zonës industriale të Kombinatit Metalurgjik, ndërkohë që te industria e mbijetuar tashmë janë punësuar vetëm pak mijëra banorë duke lënë pjesën tjetër të popullsisë të papunë. Zonat malore përreth Elbasanit kanë infrastrukturë rrugore të keqe ose relativisht të keqe si dhe të kushtueshme për t'u mirëmbajtur. Parku kombëtar i Gjinarit në krahinën historike të Shpatit është i përshtatshëm për turizëm të natyrës dhe të kulturës, por është duke u dëmtuar vazhdimisht nga prerjet e paligjshme të pyjeve.

## **Larmia faunistike**

### **FLORA DHE FAUNA**

Flora dhe fauna në Qarkun e Elbasanit karakterizohet nga një shumëllojshmëri. Keshtu flora dallohet për kultivimin e shumë bimeve mjekesore dhe etero-vajore si: rozmarine, trendafil i eger, dellenje, shtogu, sherebel, brumez, levanto, frasher, gjineshtra, luleshtrydhe, fieri grurit, rigoni etj.

Nga pyjet, të cilat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme përmendim pyjet e ulta dhe shkurret. Rriten bima e maresë, pisha, dushku, gjineshtra, lisi (i cili kushtezohet nga lartësia). Dellinja e kuqe e cila është rralluar për shkak të grumbullimit pa kriter.

### **Fauna**

Në gjithë territorin rriten kafshë të buta dhe të egra. Nga kafshët e buta përmendim rritjen dhe mbareshtimin e gjedheve, dheneve, derrave, kuajve, shpendeve. Teper e zhvilluar është edhe rritja e bletëve, e përhapur në zona të veçanta. Nga kafshët e egra rriten dhelpër, ujku, kunadhja, ariu, derri, macja e eger, vjerdulla, nuselala, baldosa, ketri, thellenxa, kaprolli.

### **Pasurite ujore (lumenjtë, liqenet, rezervuarët, ujërat nentokesore, ujërat minerale).**

Qarku i Elbasanit përshkohet nga dy lumenj kryesorë, Shkumbini dhe Devolli. Lumi i Shkumbinit i cili buron në juglindje të Shqipërisë dhe shkon drejt perëndimit, lag tre rrethe të qarkut Elbasan, (Elbasan, Librazhd dhe Peqin). Pëllgu hidrografik i Shkumbinit përkon me basenin ujembajtës të Shkumbinit me një zonë 2.511 km<sup>2</sup>. Gjate rrugës ky lum furnizohet nga dege me pak të rëndësishme si: Gostima, Rrapuni, Zaranika etj. Lumi Devoll i cili përshkon rrethin e Gramshit furnizohet nga perrenjtë të vegjël si: perroi i Holtes etj.

Liqenet që takohen në qarkun e Elbasanit janë të shumta. Ato me kryesorë janë 82 liqenet karstike të Dumresë dhe një numër i madh burimesh me dalje sipërfaqesore dhe ujembledhës ujites. Numri i rezervuarëve të ndërtuar nga shteti është 46. Ata sot janë efektive, por kanë nevojë për nderhyrje. Disa prej tyre janë: rezervuari i Treganit, i Funarit, në rrethin Elbasan rezervuari i Kullollasit (Prrenjas), i Gjocaj (Peqin) etj. Rezervuarët dhe liqenet janë të përhapur në të gjithë qarkun dhe vëllimi i tyre është afërsisht 37 408 000 m<sup>3</sup> ujë. Aftësia ujitesë është 11 983 ha. Kanalet ujitesë të parë janë 557 km dhe të dytë 1310 km. Nder to kryesorë janë: kanali Naum Panxhi, i Suloves, i Ferrasit, i Valamars, i Dragostunjes, etj.

Qarku i Elbasanit është i pasur me ujëra nentokesore të cilat janë burime të ujit të pijshëm për të gjithë popullsinë e qarkut. Në rrethin e Elbasanit vëllejnë të përmendet burimet e Krastes, të Mengelit, të Griqanit të cilat sigurojnë ujë të pijshëm për gjithë qytetin e Elbasanit. Burimet e ujembledhës të rajonalit të Dumresë i cili siguron ujë të pijshëm për të gjithë zonën, burimet e Spatharit që sigurojnë ujë të pijshëm për Librazhdin, burimi i Kerpices në zonën e Gramshit si dhe burime të tjera nga pusët në breg të Shkumbinit. Vlen të theksohet zona ujembajtëse për ujë industrial e Kombinatit Metalurgjik Elbasan i cili është klasifikuar ndër me të mëdhatë në rajon.

## **VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.**

Eksperiencën disa vjeçare të veprimtarisë ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe, menaxhimit të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshi këtu edhe të mbetjeve urbane.

### **5.1. Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme, në mjedis.**

a. Shkarkime në ajër.

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit në zonë. Të vetmet shkarkime në ajër do të jenë gaze apo grimca pluhuri, të cilat gjenerohen nga lëvizja e mjeteve që përdoren në funksion të aktivitetit, të cilat në pikëpamjen mjedisore dhe shëndetësore këto ndikime mund të konsiderohen të papërfillshme. Nuk gjenerohen shkarkime të konsiderueshme në ajër, por bëhet monitorimi i vazhdueshëm i zonës përreth aktivitetit për kontrollin e cilësisë së ajrit.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Zhurma në nivele minimale do të gjenerohen nga mjetet e transportit, të cilat përdoren nga kompania. Gjithashtu dhe nga makineritë për përdoren për proceset teknologjike në këtë subjekt. Këto zhurma do të jenë brenda normave të lejuara, duke mos shkaktuar shqetësim për banorët e zonës.

c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit do të gjenerohen këto tipologji mbetjesh:

**1. Mbetjet urbane (Letra, qese, Karton etj) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas.**

**KOD 20 01 01** Letër dhe karton

**KOD 20 01 02** Qelq

**KOD 20 01 39** Plastikë

Mbetjet urbane të krijuara nga stafi, nuk përbëjnë rrezik për ndotjen e tokës apo të mjedisit ku do të hidhen dhe për këtë arsye konsiderohen mbetje të parrezikshme. Për sa i përket mënyrës së trajtimit/asgjësimit dhe menaxhimit të tyre ato do të depozitohen në kontenier të posaçëm të vendosura nga subjekti. Për menaxhimin e tyre, subjekti ka vendosur kosha me ngjyra në ambientet e instalimit, me qëllim diferencimin e tyre që në burim. Kontenierët do të jenë gjithashtu edhe të mbyllur, për të evituar përhapjen e aromave të pakëndshme sidomos në kohë me temperature të lartë dhe në kontakt me lagështirën.

Në fund të çdo pune, mbetjet e ngurta urbane subjekti do t'i depozitojë në vendin e përcaktuar për to nga Njësia Vendore.

**2. Mbetjet e krijuara nga aktiviteti**

Proçesi i grumbullimit, seleksionimit, përpunimit dhe grirjes së materialeve të plastikës për riciklim në subjekt është i ndërtuar në formë të tillë që çdo mbetje plastike e krijuar (HDPE, PVC, PE) rifuten në proçesin e prodhimit si lëndë e parë. Kjo për arsye të rritjes së eficensës së punës por edhe për mbrojtjen e mjedisit.

Nga aktiviteti i shndërrimit të gomës gjenerohet një sasi mbetjesh, ku shumica riciklohet. Menaxhimi i mbetjeve brenda zonës së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Elbasan.

Mbetjet e ambalazhura (lëndë e parë) për industrinë e riciklimit transportohen me mjetet e shoqërisë drejt impianteve të riciklimit të mëtejshëm të tyre me qëllim ripërdorimin sa me eficient të tyre, duke ulur kostot e prodhimit për shumë produkte. Proçesi i shndërrimit të gomës është një proçes i mbyllur i cili njëkohësisht redukton mbetjet urbane nëpërmjet grumbullimit dhe që nuk emetojnë pluhura dhe me kontakte minimale me elementët e mjedisit.

Mbetjet i nënshtrohen proçesit të seleksionimit manual nga punonjësit e subjektit. (Mbetjet e papërdorshme depozitohen në kontenierë të posaçëm).

Më pas Mbetjet e gomës nëpërmjet mjetit të transportit të tipit PIRU transportohen në makinerinë e grirjes së gomës, për ti ripërdorur në proces.

Në kushtin 8 të lejes mjedisore për të cilin subjekti aplikon për ndryshim kushtesh të përmendur më lart janë vendosur mbetje të rrezikshme të cilat subjekti nuk i gjeneron dhe për më tepër e ripërsërisim që gomat sipas katalogut të mbetjeve nuk konsiderohen mbetje të rrezikshme. Subjekti "IMPULS INDUSTRI" sh.a nuk gjeneron mbetjet me kodin:

19 01 07\*-mbetjet e ngurta nga trajtimi i gazeve

19 01 11\*-hira fundore dhe llumra që përmbajnë substanca të rrezikshme pasi llumrat e gomës që gjenerohen janë mbetje të parrezikshme dhe ripërpunohen në procesin pasardhës së bashku me mbetjet e tjera të gomuara duke mos i konsideruar si mbetje por si lëndë e parë në procesin e prodhimit.

19 01 13\*-hi fluturues që përmban substanca të rrezikshme pasi e ritheksojmë se subjekti nuk e ka fare si produkt.

19 01 15\*-pluhur kaldajash që përmbajnë substanca të rrezikshme pasi subjekti nuk disponon kaldajë për ngrohje por përdor vetëm energji elektrike për procesin teknologjik.

19 01 17\*-mbetje të pirolizës që përmbajnë substancë të rrezikshme pasi nga piroliza e gomës nuk gjenerohen mbetje të rrezikshme.

19 01 12-hira fundore dhe llumra, të tjera nga ato të përmendura në 19 01 11 pasi llumrat e gomës që gjenerohen ripërpunohen në procesin pasardhës së bashku me mbetjet e tjera të gomuara duke mos i konsideruar si mbetje por si lëndë e parë në procesin e prodhimit.

19 01 14-hi fluturues tjetër nga ato të përmendura në 19 01 13 pasi e ritheksojmë se subjekti nuk e ka si produkt.

19 01 16- pluhur kaldajash të tjera nga ato të përmendura në 19 01 15 pasi subjekti nuk disponon kaldajë për ngrohje por përdor vetëm energji elektrike për procesin teknologjik.

19 01 18- mbetje të pirolizës të tjera nga ato të përmendura në 19 01 17 pasi nga piroliza e gomës nuk gjenerohen mbetje të këtij lloji.

19 01 19-rërat nga shtresat vluese pasi nuk e gjeneron nga procesi i prodhimit.

Kodet e mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti janë 19 01 02-materiale ferore të dala nga huret fundore për të cilat subjekti ka lidhur kontratë me KURUM INTERNATIONAL sh.a, mbetje urbane, leter dhe karton.

d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Kemi të bëjmë me një zonë industriale, me destinacion zhvillimin e proceseve industriale prej shumë vitesh. Kështu në këtë zonë, ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjrike, rrugësh etj. janë të përfunduara. Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjrike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për t’u shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokëse shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e më sipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujerave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

## 5.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zones.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerie egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuara. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundëshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.



b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkoshëm.

Në rastin tonë, kemi të bëjmë me ndikime të përkohëshme negative të shkarkimeve në mjedisin psh shkarkimi i gazeve, zhurmave etj.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe rigjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimit të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identikuara nga zhvillimi i procesit të grumbullimit, seleksionimit, përpunimit dhe grirjes së materialeve të plastikës për riciklim, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

## VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjykojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;

ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohëshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influencë mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përkeqësim të treguesve cilësorë aktualë të mjedisit.

## IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjrike të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

## X. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europian. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjije të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

## XI. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Kështu duhet të pranojmë që personeli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në realizimin e prodhimeve të përcaktuara si dhe në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjrike (ndërtesë, rrjete inxhinjrike etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojmë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarije.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundëshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonëshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedura të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome etj. Çdo të bëhet me trullin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjerat? Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarije nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

## XII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve
Gaze dhe Ndotës të ngurtë	Çdo 6 muaj	Shndërrimi i gomës
Niveli i zhurmave	Çdo 6 muaj	Mjetet e transportit
		Pajisjet teknologjike

- FUND-



LOERMA S.p.A.  
NIPT-107078204T